



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 116 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

**VENDIM Nr. 119, datë 25.10.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 48, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë punimeve të zbatimit të *projektit të Xhamisë së Re "Xhamija e Pashës" në Elbasan*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Durrës, Sektori Elbasan,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë punimeve të zbatimit të projektit të Xhamisë së Re "Xhamija e Pashës" në Elbasan, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Durrës, Sektori Elbasan.
2. Të kryhet nga ASHA gërmimi arkeologjik i shpëtimit, sipas konceptit të gërmimit të hartuar nga ajo, në zonën ku është zbuluar muri, me qëllim sqarimin e plotë të situatës dhe dokumentimin e strukturës së evidentuar gjatë punimeve.
3. Investitori për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, duhet të lidhë më parë akt-marrëveshje dy palëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të realizojë këtë gërmim. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit nga ASHA, sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Financave dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes dy palëshe.
5. Projekti i Xhamisë së Re "Xhamija e Pashës" në Elbasan, të kalojë për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO EURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

